




**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN**



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
VU644 – 24 – 5781 – 121/C951  
14 Nr. 790/24  
Dt. 30.09.2024

**KONTRATË FURNIZIMI**  
( Kontratë Kornizë 12 mujore )

**Palët kontraktuese :**

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**), dhe
2. “ **Avni Murtezi B.I. “emri i biznesit / NTSH “ Berveniku ” emri tregtar**, me seli në **Prishtinë**, me **NRB: 811287540** si operatorë ekonomik, përfaqësues: **z. Avni Murtezi**, në tekstin e mëtejme **SHITËSI**.

, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike kornizë, për furnizime dhe/ ose shërbime, si vijon:

Furnizimi me lëndë djegëse – pelet për ngrohje, me numër identifikues:

Nr. i prokurimit	VU644	2	4	57	8	1	1	2	1
Nr. i brendshëm	VU644	2	4	0	5	3	1	2	1

**Neni 1 Lënda**

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Furnizimi me lëndë djegëse – pelet për ngrohje për nevoja të A.K. - Vushtrri**, sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : **VU644-24-053-121**
- 1.2 Kjo kontratë është **Kontratë Publike Kornizë** dhe fillon së zbatuari ditën e nesërme pas nënshkrimit të saj ndërsa do të zgjasë **12 muaj**.
- 1.3 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Organ tjetër i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.
- 1.4 Sasi të parapara, si në pjesën II. Lista e Çmimeve, ( pjesë e Dosjes së Tenderit të Kontraktuesit – Furnizuesit ) dhe të kësaj Kontrate janë vetëm sasi indikative. Ato paraqesin një prag, nga e cili mundë të lejohet një mospërputhje e cila nuk mundë të jetë më e lartë se plus / minus tridhjetë përqind ( 30 % ).
- 1.5 Autoriteti Kontraktues është i obliguar të përdorë këtë marrëveshje kornizë kurdo që bëjnë blerjen e mallrave të përmendura në pikën 1.1.
- 1.6 Nëse Urdhërblerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të Kontratës Publike Kornizë, duke përfshirë edhe tridhjetë përqindëshin, pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, Kontrata Publike Kornizë do të ndërpritet automatikisht.

## **Neni 2 Kushtet e dërgesës**

- 2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë **10 ( dhjetë )** ditë kalendarike nga koha e lëshimit të Porosisë apo Thirrjes nga ana e Autoritetit Kontraktues apo Organit tjetër në këtë Kontratë.
- 2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimeve do të jetë vendi i saktësuar nga Autoriteti Kontraktues ( shkollat dhe objektet tjera komunale të A.K. të specifikuara në Specifikat Teknike dhe Planin e shpërndarjes, pjesë e Dosjes së Tenderit )
- 2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

## **Neni 3 Çmimi**

- 3.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimeve e paraqitur nga Furnizuesi.
- 3.2 Vlera totale indikativë e Kontratës është : **15,914.71€ ( pesëmbëdhjetmijënjëqindkatrëmbëdhjet/71 Euro).**
- 3.3. Çmimi i përmendur në Nenin 3.2 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës, me përjashtim nëse A.K. ka bërë porosi për furnizim me mall, duke shfrytëzuar edhe tridhjetpërqindëshin e lejuar sipas pikës 1.4 dhe 1.5. të nenit 1 të kësaj Kontratë kornizë.. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.
- 3.4 Pagesat do të bëhen : **në pajtim me Situacionet e aprovuara nga Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i Pranimit të Mallit– Njësive Kërkuese të Autoritetit Kontraktues.**
- 3.5 Pagesa e fundit do të kryhet pasi Furnizuesi të ketë përfunduar gjitha furnizimet e porositura prej Menaxherit të Kontratës – Komisioni i Pranimit të Mallit të Njësive Kërkuese të Autoritetit Kontraktues.

## **Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (f) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (g) Procesverbali i mbledhjes së informatave/vizitës se vendit
- (h) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

## **Neni 4 Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

---





<sup>17</sup> DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe<sup>2</sup> në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin - Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues: Komuna Vushtrri Për Furnizuesin : " Avni Murtezi B.I. " – Prishtinë

<b>Emri i ZPP</b>	Ilmi Azemi	<b>Emri i O.E.:</b>	Avni Murtezi
<b>Pozita:</b>	Drejtor	<b>Pozita:</b>	Drejtor
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	30.09.2024	<b>Data:</b>	30.09.2024
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

## KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b>gjuha Shqipe</b> .
Siguria e ekzekutimit	9.1	<b>10%(dhjetë përqindë) e vlerës së përgjithshme të kontratës.</b>
		<b>Dokumenti - Polisa e sigurimit apo dokument bankar të lëshuar nga ndonjë kompani e sigurimeve apo bankë të licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës me afat validiteti për kohëzgjatjen e periudhës prej 90 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.</b>
Sigurimi	10.1	Incotermi i aplikueshëm është DDP (Delivery Duty Paid).
Programi i ekzekutimit	11	Programi për ekzekutimin e kontratës duhet të përcaktohet brenda 30 ditëve pas nënshkrimit të kontratës.
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	DDP (Delivery Duty Paid)
Cilësia e furnizimeve	18.2	Autoriteti Kontraktues do të refuzojë çdo dërgesë të materialit i cili deshton në përmbushjen e specifikimeve minimale të cilësive të përcaktuara në specifikimin teknik.
Inspektimi dhe testimi	19.2	
Pagesa	20.1	Pagesa do të bëhet nga ana e Autoritetit Kontraktues për furnizimet e dorezuara vetëm në bazë të shumës së vlerës së një Urdhër Blerje të vlefshme të lëshuar nga autoriteti kontraktues.
Dorëzimi	21.3	Furnizuesi do t'i bartë të gjitha rreziket që kanë të bëjnë me mallrat deri në pranimin në destinacion. Furnizimet duhet të pakëtohen në mënyrë që të parandalohet dëmtimi i tyre deri në destinacionin e tyre.
		<b>Dërgesa:</b>
		Dërgesat do të bëhen brenda 30 ditëve pas marrjes së "urdhër blerjes" nga ana e Furnizuesit.
		Dorëzimi do të bëhet në një ditë pune dhe gjatë orarit të punës të Autoritetit

		kontraktues (e hënë - e premte, 8:00-16:00).
Obligimet garancionit	e 24.1	Periudha garanuese e defekteve është :
	24.5	N/A
Shërbimet pas shitjes	25.1	N/A
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	<b>Komisioni per ndermjetsim pranë Ministrise se Drejtesise</b>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatën Komerçiale-Prishtinë</b>

## Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME


Specifikat -Plani i shperndarjes për Drejtorin e Arsimit dhe Drejtorin e Shëndetsisë

N.ren.	Pershkrimi	Njesia matese	SHKOLLA E MUZIKES	IP"Foleja II"	IP"Foleja II"	SHMU-1	
			Sasia indikative per 12 muaj	Sasia indikative per 12 muaj	Sasia indikative per 12 muaj	Sasia indikative per 12 muaj	Sasia indikative per 12 muaj ne total
1	Pelet prej druri t të kualitetit të lartë A2, diametri Fi 6,gjatësia 23.5, përmbajtja e imtësive 0.7-1.5, forca mekanike 97.5, dendësia e ngritur 600, përmbajtja e lagështisë 8 neto, fuqia ngrohëse 16.32-16,55, vlera kufizuese N plus standardit.	kg	8,000.00	6,000.00	10,000.00	25,000.00	49,000.00

Nr.	Pershkrimi	Pershkrimi teknik	Njesia	Sasia indikativepër 12muaj
1	Furnizimi me pelet për nevojat e QKMF, QMF dhe AMF në depon e QMF-1 Rr.Deshmoret e Kombit nr.180 ne Vushtri	Pelet prej druri të kualitetit A2, diametri minimum Fi 6 , gjatësia 23.5, përmbajtja e imtësive 0.7-1.5, forca mekanike 97.5, dendësia e ngritur 600, përmbajtja e lagështisë 8 neto, fuqia ngrohtëse 16.32-16.55, vlersa kufizuese N plus standardit	kg	35294

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik:


Vula:



Numri i prokurimit: VU644-24-5781-1-2-1 Numri i brendshëm: VU644-24-053-1-2-1 Titulli: Furnizim me pellet për ngrohje

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G. Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%, 8% apo 18%. Nërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy numra pas presëjes dhjetore

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia indikative për 12 muaj	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSH)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
1	Pelet prej druri të kualitetit të lartë A2, diametri minimum FI 6, gjatësia 23.5, përmbajtja e imtësive 0.7-1.5, forca mekanike 97.5, dendësia e ngjitur 600, përmbajtja e lagështisë 8 neto, fuqia ngrohëse 16.32-16.55, vlera kufizuese N plus standardit.	kg	84294.00	0.16	0.18	0.19	13,487.04	2,427.67	15,914.71
<b>TOTALI PERGJITHSHEM ME TVSH</b>							13,487.04	2,427.67	15,914.71

<b>Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)</b>	
<b>Emri i OEE:</b>	N.T.SH "BERVENIKU"
<b>Adresa e plotë:</b>	PRISHTINE
<b>I përfunduar nga:</b>	
<b>Emri:</b>	AVNI MURTEZI
<b>Pozita:</b>	DREJTOR
<b>Nenshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	28.06.2024
<b>Vendi:</b>	

